



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në zbatim të nenit 21 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil N.03/L-147 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ dhe Punëdhënës merr këtë:

V E N D I M  
P Ë R  
LEJIMIN E KOMPENSIMIT PËR PUNË JASHTË ORARIT

1.Me këtë vendim, nëpunësve: Mehat Berisha Udhëheqës i sektorit për shërbime sociale në kuadër të DSHMS-QPS, i **Lejohet Kompensimi** i orëve të punuara jashtë orarit punues gjatë ditëve të punës dhe vikendit për muajin mars 2023 të rritura për 30 % dhe 50 % konform ditëve të punuara e që do të kompensohen në të holla, si në vijim:

1.1 Mehat Berisha për pagesë.....30.72 €

2. Llogaritja e orëve për pagesë të punuara jashtë orarit punues gjatë ditëve të javës dhe vikendit është bërë sipas nenit 8 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 dhe 4.5 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, e ku pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e orëve të punuara dhe llogaritja e tyre.

3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është; raporti i punës së nëpunësve civil nga pika 2 e këtij vendimi.

4.Pagesa për orët e punuara jashtë orarit punues duhet bërë nga kodi buxhetor Paga dhe mëditje – DSHMS-QPS.

5.Vendimi hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

-Nëpunësit  
-NJBNI

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni

